

Kapitulli 1. Parimet dhe elementet e artit koreografik

Pyetja 1

Hapi është element i :

- A) muzikës dhe skulpturës
- B) letërsisë dhe pikturës
- C) operas dhe vizatimit
- D) kërcimit dhe koreografisë

Pyetja 2

Lëvizja në kërcim është:

- A) e panevojshme
- B) e domosdoshme
- C) imagjinare
- D) e njëjtë me lëvizjen në fizikë

Pyetja 3

Trupi i njeriut në kërcim nënkupton :

- A) marrdhënien ndërmjet elementëve të kompozimit
- B) një element vizualo-skenik
- C) marrdhënien midis përjetimeve emocionale dhe shprehjes së tyre plastike
- D) një element të veprimit hapsinor në skenë

Pyetja 4

Plastika trupore në artin koreografik shërben :

- A) për të demonstruar aftësi fiziko-trupore
- B) për të komunikuar, dialoguar dhe transmetuar ndjesi estetike
- C) për shoqëruar melodinë muzikore
- D) për të krijuar imazhe grafike

Pyetja 5

Ritmi në kërcim përftohet:

- A) nga struktura e ritmit muzikor
- B) nga intesiteti emocional i veprimit koreografik
- C) nga shpejtësia e tempit të lëvizjeve
- D) nga teknikat kërcyese

Pyetja 6

Hapësira në kërcim është :

- A) një komponent i kompozimit koreografik
- B) një vendndodhje ku projektohet pozicioni i kërcimtarëve
- C) një hapësirë ku trajtohet një vepër artistike
- D) një zonë e papërcaktuar e skenës

Pyetja 7

Energjia në kërcim i referohet:

- A) forcës fizike të aplikuar në lëvizje
- B) gjendjes shpirtërore të kërcimtarit
- C) aktit komunikues të kërcimit
- D) cilësive dinamike të lëvizjes

Pyetja 8

Dinamika e lëvizjes në kërcim shpreh:

- A) mënyrën se si kërcimtari emocionalisht përdor lëvizjen në skenë
- B) stilin e një pjese kërcyese
- C) rutinën e hapave gjatë një veprë koreografike
- D) konceptin e kompozicional të koreografit

Pyetja 9

Gjesti në artin kërcyës përfaqëson :

- A) veprim lëvizor e një pjese të trupit që shpreh ide dhe ndjenja
- B) veprim që tregon karakterin e një personazhi
- C) veprim simbolik apo ritualistik
- D) element thelbësor të gjuhës koreografike

Pyetja 10

Kombinimi i lëvizjeve në koreografi nënkupton:

- A) organizimin e lëvizjeve me një ndjenjë vazhdimësie dhe përfundim artistik
- B) një strukturë kompozicionale fillestare
- C) një pjesë të procesit krijues në koreografi
- D) një frazë kërcimi

Pyetja 11

Motivi kërcyës është:

- A) marrdhënia fillestare që kërcimtari krijon me trupin e tij
- B) ndërthurja e impulsit të motivimit me veprimin lëvizor
- C) elementi i parë i veprimit kërcyës që lidhet me konceptin e veprës artistike
- D) një detaj i përsëritur për të theksuar një kuptim simbolik

Pyetja 12

Forma e lëvizjes tregon:

- A) modelimin e trupit në planet tredimensionale të hapësirës
- B) një balancë estetike fizike
- C) një teknike kërcyese
- D) një unitet emocional ndërmjet muzikës dhe kërcimit

Pyetja 13

Marrdhënia me veten në kërcim është :

- A) shprehje e tipareve individuale nëpërmjet lëvizjeve
- B) një mënyrë për të zbuluar vetveten
- C) një kofidencë ndërmjet reflektimit të brëndshëm emocional i çdo kërcimtari me lëvizjen e tij
- D) një kërkesë dramturgjike e veprës koreografike

Pyetja 14

Marrdhënia me partnerin dhe grupin në kërcim është :

- A) një formë fizike dhe vizuale e bazuar mbi besimin dhe mirkuptimin
- B) një formë e komunikimit të ndërsjelltë emocionalo-shpirtërore e orientuar nga një qëllim i caktuar koreografik
- C) një formë dialogu ndërmjet dy apo më shumë individëve në kërcim
- D) një reagim plastik ndaj kontaktit dhe energjisë së prekjes trupore midis kërcimtarëve

Pyetja 15

Kërcimi është :

- A) arti i shprehjes të ndjenjave të njeriut nëpërmjet lëvizjeve të trupit
- B) një veprimtari interpretuese skenike, ku mbizotëron ritmi muzikor
- C) një formë argëtimi ku përfshihen një numër i pakufizuar personash
- D) një mënyrë për të shprehur një traditë artistike

Pyetja 16

Estetika e kërcimit pasqyron :

- A) cilësitë vizuale dhe sensual të artit kërcyes
- B) një qasje ndaj shqisave të shikimit
- C) një ndërthurje e lëvizjes dhe stilit personal kërcyes
- D) harmoninë, simetrinë dhe ekujlibrin

Pyetja 17

Kompozimi koreografik identifikon :

- A) procesin krijues në artin e kërcimit
- B) aktin e hulumtimit të lëvizjes kërcyese
- C) strukturën ideore, emocionale dhe lëvizore të një vepre kërcyese
- D) bashkëpunimin e koreografit me kërcimtarët në performancën e një pjese koreografike

Pyetja 18

Termi koreografi nënkupton :

- A) kompozimin e një vepre apo pjesë kërcyese
- B) aplikimin e të dhënave të shkruara për një pjesë kërcyese
- C) kompozimin, planifikimin dhe monitorimin e lëvizjes së kërcimtarëve në një performancë skenike, brenda një konteksti emocional
- D) përfshirjen e të gjitha kërcimeve egzistuese

Pyetja 18

Trupa e baletit (corps de ballet) janë :

- A) anëtarë të një kompanie baleti që përfaqësojnë një nivel të ulët teknikme funksion dekorativ artistik
- B) kërcimtarë të një ansambli vallesh etnike
- C) pjestarë të një grupi të kërcimit modern
- D) një grup kërcimtaresh të sapo shkolluar

Pyetja 19

Balet-master përfaqëson :

- A) një personalitet i fushës së baletit me dije të thelluara artistike për artin e kërcimit që vënë në skenë balete të stilit klasik dhe romantik
- B) një profesionist i baletit që drejton mësimdhënien ditore të klasës së baletit në një trupë baleti
- C) drejtues artistik i një kompanie baleti
- D) koreografi kryesor i një institucioni të artit koreografik

Pyetja 20

Koreografi është :

- A) një artist i cili zotëron teknika të ndryshme kërcyese dhe ka aftësi të krijojë koreografi nga format më të thjeshta deri tek shfaqet e plota dramaturgjike
- B) kërcimtari që ka aftësi metodike mbi artin e kërcimit
- C) një individ që ka njohje dhe aftësi shumë të mira teknike në kërcimin modern
- D) një individ që ka njohje dhe aftësi shumë të mira teknike në baletin klasik

Pyetja 21

Koreopetitori përfaqëson :

- A) një person që krijon koreografi në kompani të ndryshme kërcimi
- B) një drejtues artistik të një trupe kërcimi
- C) një artist të kompletuar i cili siguron nivelin e lartë artistik të repertorit të shfaqeve të një institucioni profesionist në fushën e kërcimit
- D) një pjestar i një trupe internacionale kërcyese

Pyetja 22

Emërtimi balerin nënkupton:

- A) një kërcimtar të stilit modern
- B) një kërcimtar të stilit popullor
- C) një kërcimtar në teknikën e kërcimit klasik
- D) një kërcimtar në teknikën e kërcimit kontemporan

Pyetja 23

Solist baleti është :

- A) një kërcimtar me aftësi superiore në teknikën e kërcimit klasik
- B) një kërcimtar i aftë në stilit popullor

- C) një kërcimtar përfaqësues i stilit modern
- D) një kërcimtar me aftësi ekselente në teknikën e kërcimit kontemporan

Pyetja 24

Asistent koreografi përfaqëson:

- A) një person që ndihmon koreografin në zhvillimin e estetikës lëvizore
- B) një person që asiston në provat e kërcimit
- C) një kërcimtar me eksperiencë
- D) një ekspertizë teknike

Pyetja 25

Lëvizja në kërcim është:

- A) zhvendosje hapsinore
- B) qendrim statik
- C) imagjinatë
- D) shprehje shoqërore

Pyetja 26

Trupi i njeriut në kërcim është:

- A) instrument
- B) qëllim i lëvizjes
- C) subjekt informal
- D) objekt dhe subjekt levizor

Pyetja 27

Ekspresioni trupore është :

- A) shprehja e artikulimit lëvizor në kërcim
- B) qëllim i trupit për të komunikuar,
- C) forme e të menduarit kërcyes
- D) për të krijuar imazhe formash

Pyetja 28

Ritmi në kërcim përftohet:

- A) nga struktura e ritmit muzikor
- B) ndjesia e përshtatjes muziko-lëvizore
- C) nga intesiteti emocional i veprimit kërcyes
- D) nga dinamika lëvizore e trupit

Pyetja 29

Hapësira në kërcim është :

- A) një udhëtim nga një vendodhje në një tjetër
- B) nocion abstrakt
- C) mjet i kompozimit koreografik
- D) vendi ku kërcëhet

Pyetja 30

Energjia në kërcim i referohet:

- A) sasisë së forcës fizike në segmente të caktuara lëvizjesh
- B) gjendjes emocionale
- C) cilësive motorike të lëvizjes
- D) aktit komunikues të kërcimit

Pyetja 31

Dinamika e lëvizjes në kërcim i referohet:

- A) estetikës e një pjese kërcyese
- B) mënyrës se si lëvizja gjen përshtatje në trupin e kërcimtarit
- C) motiveve kërcyese
- D) konceptit koreografik

Pyetja 32

Gjesti në artin kërcyesh përfaqëson :

- A) mjet ideor
- B) veprim lëvizor i një pjese të caktuar të trupit
- C) veprim që tregon gjendje të caktuar emocionale
- D) veprim konkret

Pyetja 33

Kombinimi i lëvizjeve në koreografi i shërben:

- A) një strukture kompozicionale fillestare
- B) organizimit të lëvizjeve në funksionin estetik e ideor
- C) një dinamike të paracaktuar
- D) qasjes stilistike

Pyetja 34

Motivi kërcyesh është:

- A) struktura e parë kompozicionale e kombinimit të lëvizjeve
- B) forma e stilit kërcyesh
- C) shprehje e veprimit lëvizor
- D) një mjet për të shfaqur aftësitë teknike

Pyetja 35

Forma e lëvizjes tregon:

- A) modelimin e trupit në planet tredimensionale të hapësirës
- B) një balancë estetike fizike
- C) një teknike kërcyese
- D) një unitet emocional ndërmjet muzikës dhe kërcimit

Pyetja 36

Kush e bën lëvizjen nga utilitare në kërcyese:

- A) qëllimi i lëvizjes
- B) forma e lëvizjes
- C) cilësia e lëvizjes
- D) stili i lëvizjes

Pyetja 37

Marrdhëniet në kërcim (me partner, grup, objekte) janë :

- A) një mënyrë e të shprehurit të individualitetit
- B) shprehje e ndërveprimit për shkak të kontaktit, prezencës dhe ndjeshmërisë ndaj një apo më shumë trupash apo objektësh
- C) shprehje e relaksimit për shkak të kontaktit fizik
- D) reagim psikik si pasojë e prekjes, perceptimit dhe ndjeshmërisë shqisore

Pyetja 38

A është vetë kërcimi :

- A) një veprim shoqëror
- B) mënyra për të shprehur një traditë kulturore
- C) arti i shprehjes të ndjenjave dhe emocioneve nëpërmjet lëvizjeve të trupit
- D) një formë argëtimi fizike

Pyetja 39

Estetika e kërcimit tregon :

- A) cilësitë vizuale të artit kërcyese
- B) perceptimin vizual e stilistik të një pjese kërcyese
- C) një ndërthurje e lëvizjes dhe stilit personal kërcyese
- D) përmbajtjen ideore të pjesës kërcyese

Pyetja 40

Kompozimi koreografik identifikohet me :

- A) procesin krijues në artin koreografik
- B) aktin e kërkimit të lëvizjes kërcyese
- C) bashkëpunimin e koreografit me kërcimtarët
- D) arkitekturën e brendshme dhe linjat strukturore të një pjese kërcyese

Pyetja 41

Termi koreografi nënkupton :

- A) kompozimin e një pjese kërcyese
- B) dizajnimin e kërcimit në kohë e hapësirë
- C) realizimin e një performance skenike, me një kontekst ideor dhe emocional
- D) shkrimin e lëvizjeve

Pyetja 42

Trupa e baletit është :

- A) një grup balerinësh që veprojnë së bashku në funksion të veprimit skenik

- B) anëtarë të një ansambli të caktuar
- C) grup individësh që veprojnë në mënyrë të pavarur
- D) një grup kërcimtaresh çfarëdo

Pyetja 43

Balet-masteri është :

- A) një personalitet i fushës së baletit me dije të thelluara profesionale që inskenon balete të stilit klasik dhe romantik
- B) një mësues i baletit që drejton edukimin teknik nëpërmjet klasës së baletit në një trupë apo shkollë baleti
- C) drejtues artistik i një trupe teatri baleti
- D) koreografi kryesor i një institucioni të artit koreografik

Pyetja 44

Koreografi përfaqëson :

- A) një individ që ka aftësi krijuese në artin e kërcimit
- B) një kërcimtar dhe aftësi shumë të mira teknike dhe organizative
- C) një artist i cili zotëron aftësi të krijojë pjesë koreografike nga miniaturat deri tek shfaqet me dramaturgjë të plotë
- D) një profesionist që njeh të gjitha llojet e kërcimeve

Pyetja 45

Koreopetitori ka kompetenca :

- A) krijuese koreografike
- B) të drejtimit artistik të një trupe baleti
- C) komanduese në një grup kërcimi
- D) të një profesionisti, i cili siguron mbajtjen e repertorit të shfaqeve të një kompanie baleti

Pyetja 46

Emërtimi balerin i përket:

- A) një kërcimtari të stilit modern
- B) një kërcimtari të stilit etnik
- C) një kërcimtari në teknikat e kërcimit kontemporan
- D) një kërcimtari në teknikën e kërcimit klasik

Pyetja 47

Kërcimtar bashkëkohor është :

- A) një kërcimtar i aftë në stilit popullor
- B) një kërcimtar me aftësi ekselente në teknikën e kërcimit klasik
- C) një kërcimtar tipik i stilit modern
- D) një kërcimtar që zotëron teknikën dhe estetikën e kërcimit kontemporan

Pyetja 48

Drejtuesi artistik përfaqëson:

- A) një person që ndihmon zhvillimin e repertorit të një kompani danci
- B) një person që menaxhon një kompani danci
- C) personi që përcakton qasjet tematike, konceptuale dhe artistike të një kompanie kërcimi
- D) një kërcimtar me aftësi organizative

Kapitulli 2. Teknikat dhe proceset e kërcimit

Pyetja 1

Kërcimet historike janë :

- A) kërcime që janë aplikuar në periudha të ndryshme historike
- B) kërcime të oborrit mbretëror të shek. XIV
- C) kërcime popullore nga vende të ndryshme
- D) kërcime të shtresës aristokratike botërore

Pyetja 2

Kërcimet e sallorit janë:

- A) kërcime partneringu me karakter argëtues
- B) kërcime të shek. XII
- C) kërcime që luhen vetëm në raste të veçanta
- D) kërcime që interpretohen nga 4 apo 6 persona

Pyetja 3

Kërcimet sociale përfaqësojnë :

- A) kërcime që promovohen në shfaqje skenike
- B) kërcime që inetrpretohen në çift
- C) kërcime që u shfaqën në shek.XVIII
- D) kërcime me funksione ceremoniale, argëtuese dhe erotike

Pyetja 4

Kërcimi i karakterit nënkupton :

- A) repertorin kërcyes botëror të shek. XV
- B) një pjesë të kërcimit modern
- C) prezantimin e stilizuar teatral të valleve etnike botërore
- D) vallet karakteristike të popujve të ndryshëm

Pyetja 5

Kërcimi klasik është :

- A) një sistem teknik i kodifikuar i lëvizjes
- B) një teknikë kërcyese që u formulua në shek. XIII
- C) një teknikë kërcyese që aplikohet vetëm në Europë
- D) një tenike që bazohet tek pozicionet paralele të këmbëve

Pyetja 6

Kërcimi modern është:

- A) një teknikë kërcyese që lindi në shek. XVI
- B) një disiplinë kërcyese që përdor lëvizjet e baletit
- C) një teknikë kërcyese që aplikohet vetëm në Amerikë
- D) një teknike kreative që përdor lëvizjen e lirë për të shprehur idenë dhe emocionet

Pyetja 7

Kërcimi neoklasik përfaqëson :

- A) një teknikë kërcyese që u shfaq në shek. XIX
- B) një estetike të re të baletit klasik e prezantuar në baletet e George Balanchine
- C) një stil kërcyese që nuk përdor tekniken pointe
- D) një teknikë kërcyese që ndërthuret me kërcimin modern

Pyetja 8

Kërcimi zhaz është:

- A) një kërcim që ndërthur hapat tradicionale afrikane me stilet e lëvizjes së kërcimit modern dhe klasik
- B) një teknikë kërcyese me lëvizje të qeta, të ngadalta dhe me një ritëm të thjeshtë
- C) një kërcim që lindi në shek. XIX
- D) një kërcim që aplikohet në vendet afrikane

Pyetja 9

Kërcimi postmodern përfaqëson:

- A) vetëm një qasje radikale ndaj koreografisë dhe ndjesi e nevojës për ta rikonceptuar atë
- B) një stil kërcimi që lindi në shek. XXI
- C) një stil kërcimi që performancën e tij e vendos vetëm në skenën teatrale
- D) një stil kërcimi ku lëvizja u bë aspekti thelbësor i domethënies së kërcimit

Pyetja 10

Kërcimi kontemporan identifikohet:

- A) si një formë kërcimi që përdor vetme teknikën kërcyese të Marthe Graham
- B) si një kërcim i kodifikuar
- C) si një teknikë ekspresive bazuar në një përzierje eklektike stilesh kërcimi
- D) si një teknikë kërcimi që është e pandryshueshme dhe e kufizuar

Pyetja 11

Kërcimi urban përfaqëson:

- A) një shumëllojshmëri stilesh kërcimi që kanë origjinën në mjediset, kulturën, muzikën dhe estetikën urbane
- B) kërcime që interpretohen vetëm në skenat teatrale
- C) kërcime që kanë karakter garues
- D) kërcime që u shfaqën në fillim të shek. XX

Pyetja 12

Proceset koreografike nënkuptojnë:

- A) hapat që ndiqen për krijimin e një kërcimi
- B) mënyrat e interpretimit të një kërcimi
- C) dramaturgjinë e veprës kërcyese
- D) mënyrat e përvetsimit teknik të një kërcimi

Pyetja 13

Hulumtimi i materialit lëvizor orientohet :

- A) nga një model tradicional i lëvizjes
- B) nga një stil personal i lëvizjes
- C) nga burime të ndryshme
- D) nga stili individual i koreografit

Pyetja 14

Gjenerimi i lëvizjeve realizohet :

- A) nga një impuls fizik ose linjë energjie, që ka një fillim dhe një fund
- B) nga thekset ritmike muzikore
- C) nga alternimi i frazave lëvizore
- D) nga parimet komplekse të manipulimit të motivit kërcyese

Pyetja 15

Krijimi i strukturës së veprës kërcyese nënkupton :

- A) realizimin e qëllimit të kërcimit
- B) respektimin e strukturës muzikore
- C) zhvillimin e vazhdueshëm të idesë së lëvizjes si një llogjikë estetike
- D) parimet formale koreografike

Pyetja 16

Elementet e kompozimit koreografik janë:

- A) hapësira, koha, forma, trupi dhe energjia
- B) eksplorimi i mënyrave për të imituar ose simbolizuar realitetin në kërcim
- C) materialet lëvizore të përzgjedhura
- D) elementët e strukturës muzikore

Pyetja 17

Struktura kompozicionale në kërcim nënkupton:

- A) mënyrën se si organizohen dhe kombinohen lëvizjet dhe elementët e koreografisë
- B) mënyrën se si muzika dhe ritmika e saj ndikon mbi energjinë e lëvizjes
- C) mënyrën se si eksplorojmë mundësitë e performancës lëvizore
- D) mënyrën se si thellojmë kuptimin ndaj kërcimit

Pyetja 18

Performimi i kërcimit është :

- A) prezantimi nga kërcimtari i gjuhës kërcyese në përshtatje me estetikën koreografike
- B) kuptimi i veprës kërcyese
- C) përdorimi i elementeve të kërcimit
- D) saktësia e trajtimit ritmik të lëvizjes

Pyetja 19

Vlerësimi i kërcimit nënkupton:

- A) gjykimin estetik të kërcimit dhe koreografisë
- B) korrektesinë dhe përpikmërinë e performancës lëvizore
- C) standartin cilësor të interpretimit
- D) interpretimin e unifikuar të lëvizjes kërcyese

Pyetja 20

Ecjet teknike janë:

- A) hapat që kanë gjatësi përtej hapit natyral
- B) hapat që kanë kontakt të mirë me tokën, ndryshueshmëri dhe mprehtësi ritmike
- C) hapat që realizojnë kalimin e peshës trupore nga një këmbë në tjetrën
- D) hapat e qetë, të qartë dhe harmonike

Pyetja 21

Vendosja e kërcimtarëve në hapësirë tregon:

- A) kontaktin me partnerin
- B) zonën e lëvizjes dhe kordinimit të saj nga brenda jashtë
- C) mbushjen e saj
- D) korrektesinë stilistike, muzikalitet dhe qartësi teknike

Pyetja 22

Impulsi lëvizor shpreh :

- A) procesin e sekuencave lëvizore
- B) motivim për të lëvizur
- C) një ngjarje neuromuskulore e provokuar nga një mendim i caktuar
- D) një produkt të muskujve të trupit

Pyetja 23

Izolimi në kërcim tregon:

- A) lëvizjen e një gjymtyre të caktuar, kur të tjerat qëndrojnë të palëvizshme
- B) eksplorim të potencialeve lëvizore
- C) një moment të pasivitetit trupor
- D) një energji të munguar trupore

Pyetja 24

Pikat fokale në hapësirë janë :

- A) përcaktimi i drejtimit lëvizor
- B) impulse që motivojnë lëvizjen

C) rezultat i qëllimit lëvizor

D) orientim për të udhëtuar lëvizjen qartësisht dhe saktësisht në hapësirë

Pyetja 25

Koncepti leit-motiv në koreografi nënkupton një:

A) element i kompozicionit lëvizor i lidhur me një ide

B) një manipulim i formës trupore nga krijuesi

C) një mënyrë për të lidhur pjesët e veprës në një të tërë

D) një model themelor i lëvizjes që mbizotëron në gjithë veprimin kërcyese

Pyetja 26

Motivi është :

A) në veprim hapsinor i një teknike kërcyese

B) një koncept lëvizor që përmban stilin dhe imazhin e kërcimit

C) momenti fillestar i procesit krijues që i jep veprës elementin e parë të formës kërcyese

D) një sekuencë e lëvizjes që përsëriten

Pyetja 27

Fraza koreografike nënkupton :

A) një formë strukturore koreografike që lidhet me konceptin dhe idenë e saj

B) një sekuencë lëvizjesh të lidhura me një ndjenjë vazhdimësie dhe përfundimi artistik

C) një seri lëvizjesh që lidhen llogjikisht duke formuar një shprehje kërcyese

D) lëvizje që lidhen vetëm me muzikën

Pyetja 28

Teksti koreografik përfaqëson :

A) tërësia e lëvizjeve dhe konceptimi i tyre në planin emocionalo- teknik nga koreografi

B) një element i vetëm i interpretimit të veprës kërcyese

C) një element i parëndësishëm i procesit të realizimit të kërcimit

D) një element koreografik që krijohet nga kërcimtari

Pyetja 29

Etydi koreografik përfaqëson :

A) një skicë të shkurtër që shpreh një gjendje emocionale mbi një teknikë kërcyese

B) një proces të realizimit të kërcimit që shoqërohet me muzikë

C) një ritual i klasës së baletit klasik

D) një material kërcyese i shkurtër i krijuar për aftësimin teknik

Pyetja 30

Pantomima është:

A) arti që komunikon nëpërmjet gjesteve, plastikës trupore dhe mimikës së fytyrës

B) një proces që bazohet në çdo lloj tematike

C) një veprimtari që lindi në shek. V

D) një element shprehës i baletit modern

Pyetja 31

Kërcimi individual, varacioni nënkupton :

- A) një kërcim të shkurtër individual me tekst teknik virtuos dhe karakter argëtues
- B) një kërcim solistik që kërcëhet vetëm në baletin modern
- C) një kërcim individual që ka funksion dramaturgjik në veprën kërcyese
- D) një kërcim solistik që zberthen botën e brëndshme të një personazhi konkret

Pyetja 32

Kërcimi individual, monologu është :

- A) një kërcim solistik që ka një strukturë tre pjesëshe
- B) një kërcim solistik që trajton botën psiko-emoconale të një personazhi
- C) një kërcim solistik ku teksti koreografik i tij bazohet te teknika e kërcimeve historike
- D) një mjet i komunikimit dramatik që ka lindur në shek. XIII

Pyetja 33

Kërcimi me partner, dueti përfaqëson :

- A) një strukturë koreografike që interpretohet nga disa persona
- B) komunikimin, dialogun, marrdhëniem dhe kontaktin emocional të dy personave, mbi një teknikë kërcyese të çdo lloji
- C) një formë kërcimi që nuk bën pjesë në miniaturën koreografike
- D) një kërcim që nuk ka strukturë të njëjtë ndërtimi me pas de deux

Pyetja 34

Kërcimi me partner, trio nënkupton :

- A) një strukturë koreografike që interpretohet nga tre kërcimtarë, ku njeri ka funksion draaturgjik konfliktual
- B) një strukturë të ndryshme ndërtimi nga pas de trois
- C) krijimin e një imazhi skenik nëpërmjet një abstragimi lëvizor interaktiv me spektatorin
- D) një strukturë koreografike që nuk trajton një përmbajtje konfliktuale

Pyetja 35

Kërcimi në grup, vallja është:

- A) kërcim i sinkronizuar i realizuar me koreografi të koordinuar, ndryshime në formacion dhe dinamikë grupi.
- B) organizimi i një teksti kërcyese mbi një stilistike të caktuar, figuracion dhe parimet e ligjit dramaturgjik të ndërtimit artistik
- C) një strukturë kërcimi me numër të limituar interpretuesish
- D) një strukturë kërcimi që aplikohet vetëm në stilin modern

Pyetja 36

Procesi i realizimit të një valleje nënkupton:

- A) marrdhëniem e thellë të krijuesit me ritmin muzikor, lëvizjen kërcyese dhe karakterin e saj
- B) përgjegjësinë e çdo kërcimtari në raport me punën në grup
- C) njohjen, respektimin dhe aplikimin e pesë momenteve të ligjit dramaturgjik

D) gërshetimin e punës individuale dhe asaj në grup

Pyetja 37

Improvizimi është :

- A) aftësia e trupit për tu përgjigjur në çast stimujve të ndryshëm, duke pëdorur imazhet, ndjenjat e lindura brenda trupit, muzikën dhe hapësirën
- B) një element i procesit krijues ku ndërthuren ndërveprimi me veten, me jashtë dhe me mjetet shprehëse
- C) një element i procesit krijues në stilin e baletit klasik
- D) një element i procesit krijues që lindi në vitet '20 të shek. 20

Pyetja 38

Kontakt improvizimi është :

- A) një dialog spontan fizik mbi energjinë, instiktet themelore dhe të vërtetat emocionalo fizike
- B) një teknikë lëvizore që përdoret në të gjitha koreografitë klasike dhe neoklasike
- C) një dëshirë për ta eksploruar kërcimin në një mëyrë të lirë
- D) një ndjesi kinetike që është e njëjtë me çdo lloj tjetër parneringu

Pyetja 39

Kontakt improvizimi u krijua nga:

- A) Steve Paxton
- B) Merce Cunningham
- C) Trisha Bawn
- D) Ivonne Ranier

Pyetja 40

Kontakt improvizimi është një teknikë partneringu:

- A) ku mohohet nevoja dalluese mashkull femër
- B) që trajtohet si praktikë e vetëdijes
- C) i një transformimi të thellë fizik, emocional dhe mendor
- D) ku ndërthurret intimiteti fizik me ato emocional pas një pike të përbashkët kontakti

Pyetja 41

Kontakt improvizimi lindi si:

- A) një kërkim artistik për të gjetur mundësitë e lëvizjes nëpërmjet një kontakti fiziko sensorial
- B) një përpjekje për të rritur kapacitetet e perceptimit ndjesor të partneringut
- C) një kundërvënie e gjesteve thjesht estetike
- D) një liri e lëvizjes në partnering

Pyetja 42

Suita koreografike nënkupton :

- A) ndërthurrjen e disa pjesëve të pavarura kërcyese me një qëllim artistik të unifikuar
- B) një formë e kompozicionit koreografik
- C) një ndryshim jo thelbësor me vallen koreografike

D) shprehje e një ngjarjeje konkrete nëpërmjet kërcimit

Pyetja 43

Origjina e termit “suite” si një formë koreografike daton në :

- A) shek. XV
- B) shek. XVI
- C) shek. XVIII
- D) shek. XIX

Pyetja 44

Suita koreografike në formë rondoje nënkupton:

- A) egzistencën e një ligjerate koreografike që ndërlidh pjesët përbërëse të suitës
- B) alternimin e pjesëve masive me ato solistike
- C) organizimin në vazhdimësi të disa varacioneve solistike
- D) bashkimin e tre valleve nëpërmjet një grafiku emocional kontrastues

Pyetja 45

Skena koreografike është :

- A) një formë kompozicionale koreografike që trajton një fabul me dinamikë intensive
- B) një strukturë kompozicionale ku shprehet marrdhënia e koreografit me dramaturgjinë
- C) një ndërthurje të tekstit letrar dhe tekstin koreografik
- D) një proces të pavarur artistik bazuar vetëm në mjetet shprehëse të kërcimit

Pyetja 46

Libreti në koreografi nënkupton:

- A) një tekst të shkuar ku transmetohet përfytyrimi artistiko dhe imazhi skenik i koreografit për veprën e ardhme kërcyese
- B) një tekst dramaturgjik orientues vetëm për kompozitorin
- C) një tekst orientues vetëm për kërcimtarët
- D) një tekst që përcakton tërësinë dramaturgjike të veprës kërcyese

Pyetja 47

Kërcimet antike përfaqësojnë:

- A) Kërcimet pas epokës së erës re (pas Krishtit)
- B) Kërcimet e salloneve mesjetare
- C) Kërcimet që i përkasin epokës greko-romake
- D) Kërcime të periudhës së Ahmedout

Pyetja 48

Kërcimet historike janë :

- A) kërcime që i përkasin argëtimit mondan e aristokratik mesjetar
- B) kërcime të aplikuara në periudha të ndryshme historike
- C) kërcime të oborrit mbretëror të periudhës klasike
- D) kërcime paraklasike të popujve të ndryshëm

Pyetja 49

Kërcimi i etnik përfaqëson :

- A) një pjesë të kërcimit mesjetar
- B) traditën kërcyese burimore të një etnie të caktuar
- C) prezantimin e kërcimeve të stilizuara të etnive botërore
- D) vallet karakteristike të popujve të ndryshëm

Pyetja 50

Kërcimi i ulët është:

- A) kërcim klasik
- B) kërcim i shtresave të larta shoqërore
- C) kërcim i shtresave të ulta shoqërore
- D) kërcim karakteri

Pyetja 51

Kërcimi klasik i është :

- A) një stil kërcimi evropian
- B) një teknikë kërcyese gjithëpërfshirëse
- C) një sistem teknik i kodifikuar i lëvizjes
- D) një kërcim i lartë aristokratik

Pyetja 52

Çfare përfaqësojnë kërcimet sociale :

- A) kërcime që promovohen në skenë
- B) kërcime me funksione sociale, shoqërizuese, rekreative dhe argetuese
- C) kërcime ndërvepruese në çift
- D) kërcime që prezantojnë shijen estetike të një periudhe të caktuar
- E) festime masive të cilat mbahen në salla vallëzimi, në shtëpi ose jashtë, ku njerëzit mund të marrin pjesë në mënyrë të lirë

Pyetja 53

Kërcimi modern është:

- A) një stil i ri ekspresiv kërcimi që lindi në fillim të shek. XXI
- B) një metodikë kërcimi që riaktivizon lëvizjet e kërcimit klasik
- C) një teknikë e veçantë e identifikuar me metodika të përcaktuara autorësh.
- D) një teknike kreative që përdor lëvizjen e lirë për të shprehur idenë dhe emocionet

Pyetja 54

Kërcimi xhaz (jazz) është:

- A) një kërcim që ndërthur hapat tradicionale me stilet e lëvizjes së kërcimit modern dhe klasik
- B) një teknikë kërcyese me lëvizje të qeta, të ngadalta dhe me një ritëm të thjeshtë
- C) një kërcim që lindi në Evropë në shek. XX
- D) ndërthurje e ecjeve ritmike afrikane me stilet e lëvizjeve të ndikuara të evroamerikanëve

Pyetja 55

Estetika postmoderne e kërcimit përcaktohet nga:

- A) përdorimi i ri i kohës dhe hapësirës, një stil kërcimi që lindi në mes të shek. XX
- B) Një ekzaminim i palimit i trupit, i funksioneve dhe fuqive të tij
- C) Një këndvështrim i brendshëm, ku levizja përftohet nga një sërë zgjedhjesh, qëllimesh, planesh, skemash, rregullash, konceptesh apo problemesh.
- D) Një kërcim që nuk është i tillë vetëm për shkak të përmbajtjes, por dhe të kontekstit
- E) Një estetikë e re e cila refuzon dancing modern

Pyetja 56

Estetika e njohur si tanztheater identifikohet:

- A) Një formë specifike kërcimi që operon me vënien skenike sa koreografike po aq sa teatrale
- B) si një kërcim i lidhur vetëm me figurën e Pina Bausch
- C) si një teknikë ekspresive mbi një përzierje eklektike stilesh kërcimi
- D) si një estetikë gjermane kërcimi

Pyetja 57

Kërcimi konteporan është:

- A) një formë kërcimi që identifikohet në teknikën kërcyese
- B) një kërcim i kodifikuar narrativ
- C) një krijim pa adresë teknike
- D) një estetikë kërcimi e cila përcaktohet nga koncepti dhe stili unik

Pyetja 58

Gjuha kërcyese është:

- A) art visual
- B) mjet komunikimi
- C) lëvizje rastësore
- D) veprim i pakushtëzuar

Pyetja 59

Proceset koreografike nënkuptojnë:

- A) mënyrat e përvetësimit ideor të një kërcimi
- B) kombinimin e materialeve lëvizore
- C) procesin e krijimit dhe realizimit të një kërcimi
- D) punën me përvetësimin e një kërcimi

Pyetja 60

Kërkimi i materialit lëvizor orjentohet :

- A) nga një model tradicional i lëvizjes
- B) nga burime të ndryshme lëvizore
- C) nga qasjet imagjinare të koreografit
- D) varësisht nga koncepti dhe stilistika e pjesës koreografike

Pyetja 61

Gjenerimi i lëvizjeve shkaktohet:

- A) nga një impuls i brendshëm
- B) nga ndikimi ritmik e muzikor
- C) nga edukimi paraprak i stilistikave të kërcimit
- D) nga parimet precize të kombinimit të frazave kërcyese

Pyetja 62

Me strukturë koreografike nënkuptohet :

- A) paraqitja e formualave të njohura koreografike
- B) realizimi i ndërtimit të linjave të brendshme mbështetëse të pjesës koreografike
- C) njësimi me strukturën muzikore
- D) pamja vizive së lëvizjes si një llogjikë estetike

Pyetja 63

Elementet e kompozimit koreografik janë:

- A) vizioni i pjesës koreografike
- B) materialet lëvizore të përzgjedhura
- C) trupi, energjia, hapësira, koha dhe forma
- D) objektet dhe raportet me to

Pyetja 64

Qasja kompozicionale në pjesën koreografike nënkupton:

- A) mënyrën se si kombinohen dhe organizohen të gjithë elementët koreografikë
- B) mënyrën se si lëvizjet gjejnë përshtatje me ritmin
- C) mënyrën se si kërkojmë zgjidhje për problemet me strukturën
- D) mënyrën se si interpretojmë qëllimin e pjesës

Pyetja 65

Një shfaqje e kërcimit paraqet:

- A) prezantimin nga kërcimtari (ose grupi) të stilit kërcyese
- B) prezantimin e figuracionit kërcyese
- C) prezantimin e të gjithë elementeve shprehës në funksion të komunikimit
- D) saktësinë e sinkronizimit të lëvizjes

Pyetja 66

Vlerësimi i kërcimit nënkupton:

- A) gjykimin ideo estetik të kërcimit dhe koreografisë
- B) analizën totale artistike të pjesës kërcyese
- C) vlerësimin e aspekteve teknike
- D) interpretimin e pjesës nga aspekti kreativ

Pyetja 67

Burim i lëvizjeve kërcyese janë:

- A) ngacmimet emocionale që vijnë nga hulumtimi i realitetit objektiv
- B) ngacmimet e mocionale nga marrëdhëniet njerëzore
- C) kombinim i impregnimeve që vijnë nga dy pikat e mësipërme (A&B)
- D) rezultat i edukimit shumëplanësh teknik

Pyetja 68

Me termin ekspresion nënkuptojmë:

- A) të gjitha dinamikat e shprehjes kinetike
- B) një lëvizje të izoluar
- C) një kombinim frazash kërcyese
- D) të gjitha shprehjet mimike

Pyetja 69

Termi impresion në kërcim nënkupton:

- A) mënyrën e prezantimit të kërcimtarëve
- B) figuracionin kërcyese
- C) menaxhimin e pershtypjes ardhur nga shkaqe të ndryshme
- D) kalimet nga një gjendje emocionale në një tjetër

Pyetja 70

Vendosja hapsinore e kërcimtarëve nënkupton:

- A) rolin e formacionit të kërcimtarëve në skenë
- B) zonën e paracaktuar të zhvendosjes fizike të trupave nga një pikë në një tjetër
- C) një mjet shprehës simbolik e konceptual
- D) raporte të balancuara apo të zhbalancuara të kërcimtarëve në hapësirë

Pyetja 71

Impulsi i lëvizjes është :

- A) një lëvizje e kombinuar
- B) një arsye për të lëvizur
- C) një ngjarje neuromuskulore e provokuar nga një mendim fragmental
- D) një gjendje muskulare me dinamika të ndryshueshme

Pyetja 72

Motivi koreografik është :

- A) kombinim i lëvizjeve të një teknike kërcyese
- B) një kalim lëvizor që prezanton imazhin e kërcimit
- C) një lëvizje karakterizuese
- D) fillesa e krijimit lëvizor në procesin imagjativ

Pyetja 73

Leit-motivi tregon :

- A) një bashkim elementësh lëvizorë
- B) një modul themelor lëvizor që ripërsëritet vazhdimisht, i cili ngjyros karakterin e pjesës

- C) një përshtatje të dinamikës trupore me ritmin
- D) një trajtë lëvizore që shërben si lidhëse në strukturën e pjesës

Pyetja 74

Fraza koreografike është :

- A) një strukture fillestare lëvizore
- B) një grupim lëvizjesh të kordinuara në përshtatshmëri me stilin kërcyese
- C) një shprehje kërcyese
- D) lëvizje që lidhen vetëm me muzikën

Pyetja 75

Leksiku koreografik përfaqëson :

- A) mënyrën e interpretimit të veprës kërcyese
- B) një nga elementët pjesës koreografike
- C) shkrimin e lëvizjeve sipas një kodi të caktuar
- D) tërësinë e lëvizjeve të një pjese koreografike

Pyetja 76

Pantomima është:

- A) një tregim i njgjarjes nëpërmjet lëvizjeve
- B) një element shprehës i baletëve klasike
- C) arti i gjesteve, plastikës trupore dhe mimikës së fytyrës
- D) një veprimtari folklorike

Pyetja 77

Varacioni në koreografi nënkupton :

- A) një kërcim solistik që kërcëhet vetëm në baletin romantik
- B) një strukturë kërcyese të shkurtër individuale e cila shpalos teknikë virtuoze dhe ka karakter argëtues
- C) një kërcim me dramaturgji në veprën kërcyese
- D) një kërcim solistik që paraqet botën e brëndshme të një personazhi në balet

Pyetja 78

Monologu në koreografi nënkupton :

- A) një kërcim solistik me dramaturgji
- B) një kërcim solistik argëtues
- C) një kërcim i cili shpalos teknikën shpërthyse të solistit
- D) një strukturë integrale koreografike në balet

Pyetja 79

Kërcimi me partner (dueti) përfaqëson :

- A) një strukturë koreografike që interpretohet nga dy persona
- B) një miniaturë koreografike e kompozuar me më shumë se një person
- C) një strukturë kërcimi e lidhur vetëm me pas de deux

D) dialogun, marrdhënien e dy personave, mbi një temë e kompozim të caktuar koreografik

Pyetja 80

Trio në koreografi nënkupton:

- A) një strukturë koreografike lidhur vetëm me pas de trois
- B) një strukturë koreografike me tre kërcimtarë, ku njeri ka funksion dramaturgjik antagonist
- C) një strukturë koreografike që nuk trajton një konflikt dramatik
- D) një kërcim i çfarëdolloji egzekutuar nga tre persona

Pyetja 81

Kërcimi në grup, vallja është:

- A) kërcim folklorik realizuar me koreografi të paracaktuar
- B) një strukturë kërcimi që dallon për nga stilistika
- C) një formë e strukturuar koreografikisht mbi parimin e 5 pikave dramaturgjike, egzekutuar nga një grup personash
- D) një strukturë e lirë kërcimi me numër papërcaktuar kërcimtarësh

Pyetja 82

Improvizimi në kërcim është :

- A) aftësia e trupit të çdo individi për t'ju përgjigjur në çast ngacmimeve të ndryshme emocionale, duke pëdorur imagjinatën, impulsin brenda trupit dhe kapacitetet lëvizore
- B) një mjet në procesin krijues ku ndërveprimi me veten, partnerët hapësirën dhe kohën krijojnë lëvizje unike.
- C) një element i procesit krijues në të gjitha stilet
- D) një element i procesit krijues në dancin bashkëkohor

Pyetja 83

Kontakt improvizimi është :

- A) një teknikë lëvizore që përdoret në të gjitha stilet kërcyese
- B) një ndjenjë për të eksploruar kërcimin në partneritet
- C) një dialog spontan fizik me një apo më shumë partnerë
- D) një teknikë e lindur në vitet '70 të shek.20

Pyetja 84

Teknikën e kontakt improvizimit e ka praktikuar i pari:

- A) Merce Cunningham
- B) Ivonne Ranier
- C) Steve Paxton
- D) Pol Tailor

Pyetja 85

Suita koreografike është:

- A) një formë e kompozimi koreografik e huazuar nga muzika
- B) një strukturë që bashkon disa pjesë kërcyese, të ndryshme për nga ritmi e dinamika

- C) një strukturë njëpjesëshe
- D) një kërcim me dramaturgji

Pyetja 86

Skena koreografike është :

- A) një formë kompozicionale koreografike dramaturgjike me shumë elementë
- B) një strukturë kompozicionale ku shprehet teknika e lartë kërcyese
- C) një formë skenike që ndërthur një fabul me mjete koreografike
- D) një strukturë kompozicionale e cila ndjek linjën dramaturgjike të narracionit

Pyetja 87

Libreti në koreografi është:

- A) një tekst ngjashëm me atë të teatrit dramatik
- B) një skenar ku përshkruhen linjat narrative
- C) një tekst i shkruar ku shtjellohet ngjarja dhe transkriptimi i saj në struktura koreografike
- D) një tekst që shpjegon tërësinë e veprës kërcyese

Pyetja 88

Shfaqja e plotë koreografike nënkupton:

- A) një shfaqje baleti klasik
- B) një shfaqje baleti romantik
- C) një shfaqje baleti modern
- D) një shfaqje me dramaturgji të plotë, pavarësisht estetikës përkatëse

Pyetja 89

Karakteri improvizues i kërcimit mbaroi së egzistuari:

- A) kur lindi kërcimi definitiv
- B) kur lindi sistemi klasik i kërcimit
- C) kur u shfaqën rregullat e paracaktuara në kërcim
- D) kur lindi gjinia e baletit

Kapitulli 3. Kërcimet shoqërore

Pyetja 1

Valsi është një kërcim që u aplikua fillimisht :

- A) në shek. XX
- B) në shek. XVI
- C) në shek. XVII
- D) në shek. XIX

Pyetja 2

Valsi prejardhjen e tij e ka nga kërcimi folklorik:

- A) ländler

- B) volta
- C) lansje
- D) basse dance

Pyetja 3

Valsi solli një revolucion te kërcimet e salloneve :

- A) për teknikën e kërcimit
- B) për pozicionin e bashkuar të dy partnerëve
- C) për lëvizjet viskoze
- D) për marrdhënien emocionale që krijon ndërmjet partnerëve gjatë interpretimit

Pyetja 4

Valsi i quajtur Vjenez ka në strukturën e tij kërcyese:

- A) dy hapa
- B) tre hapa
- C) katër hapa
- D) pesë hapa

Pyetja 5

Valsi i quajtur Anglez ka në strukturën e tij kërcyese:

- A) dy hapa
- B) tre hapa
- C) pesë hapa
- D) katër hapa

Pyetja 6

Kompozitori i parë që shkruajti muzikë në ritmin $\frac{3}{4}$ të valsit ishte:

- A) Mozarti
- B) Laner
- C) Shtraus
- D) Offenbach

Pyetja 7

Rumba është një kërcim me origjinë:

- A) kubaneze
- B) angleze
- C) amerikane
- D) franceze

Pyetja 8

Rregullat bazë për stilin ndërkombëtar të Rumbës u përcaktuan në:

- A) Londër
- B) Paris
- C) Havanë

D) Milano

Pyetja 9

Rumba është një kërcim që ka:

- A) një ndjeshmëri sentimentale
- B) një ritëm të shfrenuar
- C) një karakter të theksuar sensual
- D) një karakter të gëzuar dhe festiv

Pyetja 10

Samba është një kërcim që shpreh:

- A) atmosferën, gjallërinë, harenë dhe energjinë e traditave braziliane
- B) bashkimin e kulturës ritualistike afrikane me ritmet jugamerikane
- C) jetën që sfidon mizerien
- D) një terapi shpirtërore

Pyetja 11

Samba është një kërcim që simbolizon:

- A) kërcimin brazilian
- B) kërcimin afrikan
- C) kërcimin jugamerikan
- D) apo ritet afrikane

Pyetja 12

Samba është një kërcim që shkëlqeu për herë të parë nga :

- A) interpretimi i saj nga Fred Astaire dhe Dolores Del Rio
- B) interpretimi i saj nga Carmen Miranda
- C) interpretimi i saj nga Josse Limon
- D) interpretimi i saj nga Martha Graham

Pyetja 13

Samba është një kërcim që interpretohet nën shoqërimin e rimit muzikor:

- A) 2/4
- B) 3/4
- C) 4/4
- D) 3/8

Pyetja 14

Emërtimi Samba nënkupton:

- A) një gjethe peme që bie në tokë
- B) një valëvitje të trupit
- C) një furi ere
- D) një fjongo që tundet

Pyetja 15

Kërcimi Mambo lindi në:

- A) Kubë
- B) Meksikë
- C) Brazil
- D) Amerikë

Pyetja 16

Në kërcimin Mambo trajtohet:

- A) bashkimi i ndjenjës muzikore me lëvizjen përmes trupit në një rezultat emocional
- B) një energji hapash ekspresivë
- C) lëvizja e fortë me stakaton ritmike
- D) një dialog ndërmjet dy partnerëve nëpërmjet hapave

Pyetja 17

Tangoja është një kërcim me origjinë:

- A) kubane
- B) argjentinase
- C) spanjolle
- D) meksikane

Pyetja 18

Tangoja u përhap si një formë e re komunikimi nga:

- A) nga sallonet aristokratike
- B) arti kinematografik
- C) eksperiencat emigratore
- D) ambientet e shtëpive publike

Pyetja 19

Tangoja është një kërcim që shpreh:

- A) takimin e dy shpirtërave dhe trupave që përkthejnë në lëvizje emocionet e ritmeve muzikore
- B) me lëvizjet e trupit ndjenjat e dashurisë, urrejtjes, dëshpërimit, ekstazën me pathos
- C) filtrimin e gjesteve të kavalierit në sensualitet femëror ku realizohet një dialog unik emocional
- D) Sensualitet, pasion, magji, provokim, improvizim dhe lirinë e dy personave

Pyetja 20

Kërcimi Cha-Cha-Cha lindi në:

- A) Kubë
- B) Spanjë
- C) Amerikë
- D) Meksikë

Pyetja 21

Cha Cha Cha është një kërcim që shpreh :

- A) Gërshetimin e elementëve të ndryshëm emocionale të kulturave të popujve të ndryshëm.
- B) një ngarkësë erotike dhe sensuale që favorizonte spontanitetin e lëvizjeve
- C) struktura muzikore evropiane dhe energjitë spanjolle me ritmikën e muzikës afrikane
- D) një thjeshtësi komunikative në mes dy partnerëve

Pyetja 22

Mazurka është një kërcim me origjinë nga :

- A) Polonia
- B) Gjermania
- C) Italia
- D) Rusia

Pyetja 23

Mazurka është një kërcim që u prezantua në:

- A) shek. XVIII
- B) shek. XX
- C) shek. XIX
- D) shek. XVII

Pyetja 24

Mazurka përfaqëson një kërcim që shpreh:

- A) një ndjenjë alegorie nëpërmjet goditjes së takave dhe ritmik muzikor
- B) një teknikë kërcyese të vështirë për tu përvetësuar
- C) një liri individuale
- D) një komunikim të detajuar ndërmjet dy interpretuesve

Pyetja 25

Polka është një kërcim me origjinë nga :

- A) Polonia
- B) Çekia
- C) Hungaria
- D) Sllovakia

Pyetja 26

Polka është një kërcim që u aplikua në:

- A) shek. XIX
- B) shek. XVIII
- C) shek. XX
- D) shek. XVII

Pyetja 27

Polka është një kërcim që shpreh:

- A) një dinamikë muzikore me një temporitëm kërcyes të shpejt
- B) një aftësi dhe qëndrueshmëri fizike nga kërcimtarët
- C) një natyrë optimiste, vetëbesimi dhe lehtësie
- D) qetësi nëpërmjet hapave të butë

Kapitulli 4. Analiza e artit kërcyes

Pyetja 1

Procesi i analizës së kërcimit ka për qëllim :

- A) ta studiojë kërcimin si njohuri historike dhe praktike
- B) të prezantojë zgjerimin e hapësirës së kërcimit si art
- C) të zbulojë rezultatet e këtij kërkimi artistik
- D) aftësimin për ta vlerësuar kërcimin por dhe për të rritur kuptimin mbi të

Pyetja 2

Analiza e kërcimit siguron :

- A) një strukturë për të organizuar interpretimin mbi një vepër kreografike
- B) përshfirjen e artit kërcyes në një punë kreative
- C) një trajtim thelbësor të konceptit strukturor lëvizor, kontekstit dhe performancës të një vepre koreografike
- D) një pasqyrë të qartë të lëvizjeve dhe mënyrës se si kërcimtarët bashkëjetojnë me to

Pyetja 3

Vlerësimi i veprës koreografike lidhet:

- A) me aspektin e zgjedhjes dhe trajtimit të lëndës lëvizore në kuptimin strukturor
- B) me efektiviteti që lëvizjet sjellin në kuptimin e karakterit dhe cilësive të tyre
- C) me vlerat publike që ajo transmeton
- D) me identifikimin e çdo elementi përbërës të krijimtarisë koreografike

Pyetja 4

Vlerësimi i performancës lidhet :

- A) me aspektin e ekspertizës teknike të kërcimtarëve
- B) me sjelljen me cilësi të karakterit të lëvizjeve
- C) me efektivitetin stilistik lëvizor
- D) me rezultatin e prezantuar para spektatorëve

Pyetja 5

Mënyra e prezantimit e vepre kërcyese nënkupton :

- A) mënyrën se si kërcimtari ose koreografi i referohet botës që e rrethon
- B) mënyrën se si kërcimtarët e ndajnë veten në një ngjarje unike
- C) mënyrën si kërcimtari krijon një identitet në raport me shprehjen e tij artistike
- D) rregullat që udhëheqin seleksionimin dhe kombinimin e lëvizjeve

Pyetja 6

Fjalori në një vepre kërcyese nënkupton:

- A) njësinë themelore ose lëvizjet prej të cilave është krijuar kërcimi
- B) elementin e lidhjes midis audiencës dhe performances
- C) orienton vëmendjen e shikuesit në një drejtim të veçantë
- D) një formë komunikimi midis kërcimtarit dhe audiencës

Pyetja 7

Stili i kërcimit në një vepër koreografike nënkupton:

- A) rezultatit e përdorimit karakteristik të pjesëve të trupit
- B) përdorimi i hapësirës dhe cilësisë lëvizore në të gjithë pjesët e trupit
- C) eksperiencën kulturore dominuese të cilësive të lëvizjes me atributet e personalitetit krijueso interpretues
- D) orientimi i kërcimtarit në hapësirën ku performon

Pyetja 8

Analiza në kërcim varet :

- A) nga sistemi i gjenerimit të qartësisë në vëzhgimin dhe përshkrimin e lëvizjeve tipike në kërcim
- B) nga rezultati i kërcimit që zbulon koreografinë
- C) nga marrdhënia në mes të zotërimit të lëvizjes dhe përvetësimit të saj estetik
- D) nga interpretimi definitiv i koncepteve të koreografit në raport me lëvizjen

Pyetja 9

Të analizosh një vepër koreografike do të thotë:

- A) të kesh aftësi metodike dhe informacion mbi konceptet që lidhen me sfondin socio-kulturor, strukturën, stilin e lëndës kërcyese dhe trajtimin të saj
- B) që të deshifrosh karakterin dhe cileëite e lëvizjes bashkë me kuptimin e saj
- C) të kesh një strukturë llogjike personale për të zbërthyer hallkat e zinxhirit koreograf-kërcimtar-spektator-studiues.
- D) të kesh një nivel vëmendje për të kuptuar lidhjen midis komponentëve të kërcimit

Pyetja 10

Analiza e një vepre koreografike orientohet :

- A) vetëm nga perspektiva e krijuesit dhe interpretuesit të kërcimit
- B) vetëm nga perspektiva e spektatorëve
- C) vetëm nga perspektiva e studiuesit
- D) nga perspektiva e koreografit, kërcimtarit , spektatorit dhe studiuesit të kërcimit

Kapitulli 5. Folklori shqiptar dhe repertori i A. K. K. V. P

Pyetja 1

Termi folklor nënkupton :

- A) krijimtarinë artistike anonime
- B) një art specific kolektiv
- C) një trashëgimi kulturore ku ruhen karakteristikat e një etnije ose kombi
- D) zhvillimin e artit që nga bashkësitë primitive

Pyetja 2

Folklori koreografik është:

- A) një studim shkencor i valles burimore të çdo populli si një kulturë e mirfilltë autoktone
- B) një gërshetim kreativ i festiva dhe ngjarjeve të ndryshme në shprehjen e emocioneve artistike në lëvizje
- C) një mjet i njohjes së realitetit jetësor dhe i përvetësimit të tij estetik
- D) një vallëzim që aplikohet nga një grup njerëzish që pasqyrojnë traditën e një vendi ose rajoni të caktuar

Pyetja 3

Vallet folklorike nënkuptojnë :

- A) një veprimtari kërcyese që mbahet në tubime me funksion social nga individë jo profesioniste
- B) një aktivitet kërcyes që nuk është krijuar për tu performuar në skenë
- C) egzekutimin e një tradite të trashëguar
- D) trasmetimin e tyre nga të vjetrit te të rinjtë

Pyetja 4

Me dialekt kërcimi nënkupton :

- A) stilin, karakterin, tiparet dhe individualitetin krahimor të një valleje folklorike
- B) dallimet e valleve ndërmjet krahinave
- C) ndryshimet në ritmikën e shoqërimit muzikor
- D) strukturën kërcyese dhe konceptin kompozicional

Pyetja 5

Emërtimet e valleve folklorike shqiptare janë:

- A) sipas trevave përkatëse
- B) sipas ndërtimit të mbrëndshëm lëvizor
- C) sipas karakteristikave zonale
- D) sipas karakteristikat lëvizore

Pyetja 6

Vallet pantomimë përfaqësojnë:

- A) imitime dhe veprime koreografike të karakterit të theksuar dramatik
- B) shkrirje harmonike të kërcimit, pantomimës, folklorit dramatik dhe elementëve poetike muzikor
- C) elementët ritualistik primitiv
- D) shtjellimin e fabulës në një mënyrë spontave dhe të improvizuar

Pyetja 7

“Loja e kapuçëve” aplikohet:

- A) në Malsinë e Gjakovës
- B) në trevën e Myzeqesë
- C) në shqipërinë e mesme
- D) në Labëri

Pyetja 8

“Vallet e brezave” bëjnë pjesë në :

- A) grupin e valleve epike
- B) grupin e valleve lirike
- C) grupin e valleve epiko-lirike
- D) grupin e valleve dyshe

Pyetja 9

Vallet lirike të dasmave nënkupton :

- A) valle që aplikohen gjatë ceremonialit të dasmës nga burrat dhe grate
- B) valle që interpretohen vetëm në ambjente publike
- C) valle që kanë ndërtim strukturor me lëvizje të forta dhe dinamike
- D) valle që luhen vetëm nga grate

Pyetja 10

Vallja e “Osman Takës” është :

- A) një valle epike nga zona e Çamërisë
- B) një valle e Malsisë së Madhe
- C) një valle Myzeqare
- D) një valle e zonës së Devollit

Pyetja 11

Vallja “Arbëreshe” përfaqëson :

- A) një pjesë të trashëgimisë tonë kulturore që ruhet dhe aplikohet jashtë trojeve tanë
